



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 22.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara dhe buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në projektbuxhetin e vitit 2020.
2. Shqyrtimi , në parim, i raporteve të 4 prej komisioneve të Kuvendit për projektbuxhetin e vitit 2020. Përkatësisht:

“Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”

“Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë”

“Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik”

“Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Senida Mesi, Reme Lala, Suzana Topi, Krenar Ryçi, Evis Kushi, Arben Elezi, Korab Lita, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Ylli Shehu, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko

Mungojnë:

Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Anastas Angjeli

Të ftuar:

Ministrisa e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

1. Z. Bledar Çuçi – Minister
2. Z. Irfan Tarelli – Dr. Pergjithshëm / Drejtoria e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

3. Z. Ardian Maçi – Dr. Pergjithshem / Drejtoria e Pergjithshme Ekonomike dhe e Sherbimeve Mbeshtetese
4. Z. Agron Vata – Drejtor / Drejtoria e Buxhetimit dhe Menaxhimit Financiar

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në projektbuxhetin e vitit 2020. Si pikë të dytë kemi shqyrtimin e raporteve të katër komisioneve dhe votimin e tyre në parim.

Të ftuar në komision janë zoti Bledi Çuçi, ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i shoqëruar nga stafi i tij, për të ndarë me ne gjithë logjikën e politikave të reformave brenda ministrisë që ai ka përgjegjësi, të investimeve dhe shpenzimeve apo çfarëdolloj gjëje që ministri do të ndajë me ne në lidhje për zhvillimin e sektorit.

Fjala për ju, zoti Ministër.

Bledar Çuçi – Faleminderit kryetar!

Të nderuar kolegë,

Buxheti për vitin 2020 për sektorin e bujqësisë në terma financiarë është rreth 11,4 miliardë lekë apo në krahasim me vitin 2019 është 15% më i lartë. Sipas programeve, për zërin shpenzime për fonde pagash kemi rreth 1,8 miliardë lekë në vitin 2020 apo 2% më shumë sesa viti 2019; për shpenzime operative rreth 2,5 miliardë lekë apo një rritje prej 16% nga viti 2019; për investime të brendshme rreth 3,3 miliardë lekë apo 16% më shumë krahasuar me vitin 2019 dhe për investime të huaja rreth 3,7 miliardë lekë apo 22% më shumë sesa buxheti i vitit 2019.

Buxheti i vitit 2020 parashikon të mbështesë disa nga reformat thelbësore që ka ndërmarrë apo që do të ndërmarrë gjatë vitit 2020 Ministria e Bujqësisë. Këtu vlen të veçojmë reformën në sektorin e veterinarisë, ristrukturimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, mbështetje financiare për të dyja skemat, qoftë për skemën kombëtare qoftë për “IPARD 2”, pra

programin e BE-së për ndihmën e sektorit të bujqësisë në Shqipëri dhe investime në infrastrukturën bujqësore dhe sigurinë ushqimore.

Po t'i shohim në mënyrë të përmblodhur për secilin nga këto programe, do të veçoja që në investimet në infrastrukturë në total buxheti është rreth 3,1 miliardë lekë nga cilat 2,45 miliardë lekë janë investime, nga këto 1,7 është investimi i brendshëm dhe 0,75 miliardë janë investime të huaja dhe 0,71 miliardë janë lekë shpenzime. Përkatësisht në ujitje me një financim prej 563 milionë lekë, nga të cilat rreth 420 milionë do të përdoren për vazhdimin e financimit për përfundimin e punimeve në 22 skema ujitëse të bashkive që kanë filluar në vitin 2019, si dhe rehabilitimin e disa skemave ujitëse në administrim të ministrisë ku mund të përmendim apo të veçojmë skemën ujitëse të Armenit në bashkinë Selenicë, kanalin ujitës të Postribës në Bashkinë e Shkodrës, kanalin ujitës U13 në Bashkinë e Kurbinit apo të Doftisë në Gjirokastrë.

Impakti që pritet prej këtyre ndërhyrjeve është përmirësimi i ujitjes në rreth 17 mijë hektarë, nga të cilat 13 mijë hektarë nga përfundimi i rehabilitimit të 22 skemave ujitëse të bashkive. Me financim të huaj janë parashikuar rreth 755 milionë lekë kryesisht me projektin e burimeve ujore dhe ujitjes së Bankës Botërore. Gjatë vitit 2020 do të përfundojë rehabilitimi i 7 skemave ujitëse që kanë filluar në vitin 2019 dhe këto janë dega e Lushnjës dhe dega e Çukazit...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mbani qetësi të dëgjojmë ministrin!

Bledar Çuçi - ...skema e Leminotit në Maliq, skema e Sllanicës në Urën Vajgurore, skemat Tregan në Has, si dhe do të fillojmë me skemën ujitëse të Janjarit që shtrihet në bashkinë e Konispolit, duke e çuar në 21 mijë hektarë sipërfaqen e rehabilituar nga ky projekt dhe 258 milionë lekë do të përdoren për rehabilitimin e 8 digave si objekte në vazhdim të financuara dhe ky financim ka filluar në vitin 2019. Për t'u mbrojtur nga përmytjet me financimin me rreth 627 milionë lekë parashikohet të ndërhyhet në rreth 15 objekte të mbrojtjes nga përmytja, kryesisht mbrojtja nga lumenjtë Shkumbin, Drini i Zi, Vjosë, Seman dhe Drinos, si dhe rehabilitimin e kanaleve të ujërave të larta në zonën e Kurbinit dhe të Mamurrasit, ku kemi pasur problematika më të mëdha nga reshjet e ditëve të fundit. Këto ndërhyrje do të mundësojnë rehabilitimin dhe ndërtimin, varësisht nga rasti, të rreth 25 kilometrave argjinaturë mbrojtëse dhe sistemin e rreth 27 kilometrave të kanaleve të ujërave të larta në Kurbin, duke minimizuar rrezikun nga përmytja në zonat që i përkasin bashkive Lushnjë, Dibër, Rrogozhinë, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Berat, Kurbin e të tjera.

Në hidrovore parashikohen rreth 60 milionë lekë për rikonstrukcionin e plotë të hidrovorit të Çukës në Sarandë dhe garantimin e kullimit për rreth 900 hektarë tokë bujqësore. Ndërsa me shpenzimet operative, pra me 458 milionë lekë, kemi parashikuar të pastrojmë rreth 235 kilometra kanale kryesorë kullues dhe rreth 65 kilometra kanale kryesorë ujitës, si dhe mbajtjen në gatishmëri teknike të 27 hidrovoreve. Këto punime, pra mirëmbajtja me shpenzime operative synojnë ruajtjen e ritmit të punës ciklike vjetore, për përmirësimin e ujitjes në rreth 25 mijë hektarë përpara sezonit ujitës dhe përmirësimin e kullimit të rreth 45 mijë hektarëve, si dhe garantimin e kullimit me ngritje mekanike për 70 mijë hektarë.

Për skemat e mbështetjes, skema kombëtare, fondi i parashikuar këtë vit është 843 milionë lekë. Skemën e kemi ende në proces diskutimi e konsultimi për identifikimin e sektorëve që do të mbështeten dhe masat mbështetëse përkatëse komplementare dhe sigurisht, duke mënjeluar të gjithë mbivendosjet me programin “IPARD 2” që është në zbatim. Do të vazhdojë praktika e nisur për aplikim me zero dokumente për masat direkte.

Në lidhje me IPARD-in fondi i parashikuar për vitin 2020 është 540 milionë lekë financim i brendshëm dhe 1,5 miliardë lekë financim i huaj. Risi për vitin 2020 do të jetë që, përveç tri masave ekzistuese gjatë vitit 2019 për mbështetje nga programi i IPARD-it, do të përfshihet edhe masa për asistencën teknike.

Sa i takon veterinarisë dhe siguri të ushqimore, duke e krahasuar me vitin 2019, viti 2020 për programin “Siguri ushqimore dhe mbrojtje e konsumatorit” rezulton se kemi një shtesë prej 204 milionë lekë në zërin investime të brendshme krahasuar gjithmonë me 2019-ën, vetëm ndryshimi; 100 milionë shtesë krahasuar me 2019-ën në zërin investime të huaja dhe kemi një ulje prej 57 milionë lekë në zërin shpenzime operative krahasuar me vitin 2019. Synimet kryesore të programit të siguri të ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit për vitin 2020 lidhen kryesisht me reformën veterinare dhe forcimin e siguri të ushqimore. Për vitin 2020 kemi parashikuar të fillojmë zbatimin e reformës në fushën e veterinarisë dhe gjatë këtij viti parashikojmë një rritje afërsisht 2,5 herë të numrit të veterinerëve, duke ofruar shërbim veterinar më afër fermerëve. Gjithashtu, për vitin 2020 kemi parashikuar edhe riorganizimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në të cilin do të kalojnë disa funksione kontrolli në stabilimentet ushqimore, të cilat deri tani kryheshin nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe kjo jo vetëm që do ta forcojë më tepër sigurinë ushqimore, por do të ulë edhe barrën e inspektimit për biznesin. Janë afërsisht 15 mijë biznese ose më shumë se 60% e bizneseve të listuara në regjistrin

e Inspektoratit Shëndetësor, që do t'i kalojnë për inspektim vetëm AKU-së, duke eliminuar në këtë mënyrë inspektimin nga dy organe inspektimi për të njëjtën kategori biznesesh.

E fundit, në lidhje me peshkimin. Në vitin 2020 do të bëhet i mundur investimi në markatën e peshkut të Vlorës me një shumë prej 190 milionë lekë, si dhe do të hapim mundësi për kreditë italiane prej 25 milionë eurosh për rehabilitimin e tre porteve të peshkimit dhe ndërtimin e disa moleve për peshkim të vogël artizanal. Këtë vit do të vihet në funksionim sistemi i *blu box*-it me një financim prej 165 milionë lekësh, një kërkesë kjo që vjen drejtpërdrejtë nga detyrimet që kemi nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Kjo ishte në mënyrë të përmbledhur buxheti për sektorin e bujqësisë për vitin 2020. Mbetemi të hapur për çdo pyetje, përgjigje, koment apo diskutime.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Ju përgëzoj për punën që keni bërë gjatë këtij viti, e cila besoj se është reflektuar edhe në rritjen e sektorit me gati 2% të prodhimit të brendshëm bruto. Ju falënderoj edhe për një element tjetër që është tejet i rëndësishëm, i cili ka të bëjë me rritjen e eksportit të produkteve bujqësore me 14,3%!

Ajo që dua të theksoj është që vitin e kaluar është bërë shumë debat për politikat bujqësore dhe shumëkush pretendonte që me uljen e rimbursimit do të binte eksporti. Unë, ju dhe Kryeministri i quajtmë të qëllimtë dhe të paditur. Po sot? Fakti se eksporti është 14,3% tregon për qartësinë e asaj politike që Kryeministri, ju si ministër në ardhje në detyrë për atë periudhë për bujqësinë, së bashku me mua, kemi pasur të drejtë. Në finale, nuk ka gëzon fakti që kemi pasur të drejtë, por na gëzon fakti që nga kjo kanë përfituar qytetarët dhe fermerët dhe vendi nëpërmjet rritjes së eksportit ka mundur të tërheqë më shumë valutë, të ardhura për ata të punojnë në terrenin bujqësor.

Gjithashtu, ju falënderoj ju personalisht për atë gjë, që në këndvështrimin tim, jo vetëm personal, e keni bërë në mënyrë dinjitoze dhe të veçantë, prezantimi në terrenin bujqësor i shumë sukseseve të bujqësisë nëpërmjet, në dukje të disa projekteve apo prekjeve modeste të territorit që shumëkush ose pakkush edhe mund t'i ketë ironizuar. Dua t'ju falënderoj në emër të komisionit, të paktën pjesa e maxhorancës, por edhe personalisht për atë prezantim dhe *PR* që i keni bërë fermerit në bazë. Më besoni që komisioni ju ka ndjekur në vazhdimësi, shumëkush mund edhe të ironizojë, por shifrat janë shifra, faktet janë fakte, terreni është terren dhe prekja

juaq që nga portokallet, mandarinat, qepët, domatet, serat, hipja në pajisje bujqësore, që nga fushat, nga kanalet ujitëse, nga tregu, nga të shijuarit, të provuarit për të transmetuar besimin që duhet të kemi te produktet bujqësore, më besoni bëjnë efekt pozitiv dhe do t'ju lutesha që ta vazhdoni dhe të mos dekurajoheni nga një, dy, tre apo pak ironi që e bëjnë nga tryeza e një zyre ose nga komoditeti i një njeriu që pi kafën larg punës.

Kisha dy pyetje, po njëres, në fakt, iu përgjigj përfaqësuesi i Ministrisë së Financave. Zoti Ministër, çfarë ka ndodhur me çmimet e imputeve bujqësore të importuara? Sa janë çmimet e pakicës të fermerit?

Ndërsa pyetjes se sa është rritur importi i produkteve bujqësore, më thanë që është 14,3%. Ma konfirmoni dot këtë shifër, që është shumë e kënaqshme?

Bledi Çuçi – Po, e konfirmoj. Kjo është shifra e gjashtëmujorit, që ka nxjerrë INSTAT-i.

Arben Ahmetaj - A mund të më flisni më tepër për gamën e eksporteve dhe vendet, të lutem, pastaj për çmimin?

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Është i padiskutueshëm dhe fakt kokëfortë, sepse është nga të dhënat më të sakta që ka shteti shqiptar, niveli i eksporteve dhe importeve në përgjithësi, por në rastin konkret për sektorin e bujqësisë.

Jo pa dëshirë do të doja ta thosha edhe në komisionin tuaj që për herë të parë në 30 vjet, Shqipëria ka zbritur në shifrën 1 me nën 3 për sa i përket raportit të import-eksportit, apo eksport-importit, pra, 1 eksportojmë dhe 2,9 arriti në gjashtëmujorin e parë raporti i eksport-importit. Të mbajmë parasysh një gjë, që në vitin 2013 ka qenë 1 me 6, pra kjo tregon se sektori i bujqësisë në këta vjet ka shënuar një progres që duhet ta njohin të gjithë, pavarësisht anës politike që i përkasim apo nga cili sektor vijmë.

Pa diskutim, sot harta e vendeve që marrin produkte bujqësore shqiptare është shumë më e gjerë. Vetëm në Europë janë 25 vende që marrin produkte bujqësore duke filluar që nga Norvegjia e deri në Greqi, por edhe përtej. Ka produkte që shkojnë në të gjitha kontinentet duke filluar nga Australia, Afrika, Amerika dhe Azia kryesisht kjo lidhet me bimët medicinale aromatike, por fakt mbetet që gjatë këtij viti kemi pasur një rekord, një përmbysje domethënëse të raportit eksport-import të produkteve bujqësore.

Në lidhje me çmimet e imputeve bujqësore, çmimeve me pakicë edhe ne kemi qenë të shqetësuar, zoti kryetar, sepse ka qenë një politikë që e kemi ndërmarrë këtë vit për herë të parë

duke bërë TVSH-në e imputeve bujqësore zero. Meraku ynë ka qenë që kjo gjë të shtrihej dhe përfitimi të ndihej te fermeri. Në qershor unë kam ngritur një grup pune për kontrollin e 25 produkteve të imputeve bujqësore dhe në raportin që ka sjellë grupi i kontrollit ka rezultuar që ka pasur ulje, por nuk ka qenë e njëtrajtshme për të gjitha imputet. Zbritja e çmimeve ka variuar nga 12% deri në 18, 19 apo 20%.

Arben Ahmetaj - Zoti Ministër, këtë element do ta doja zyrtarisht dhe të referuar. Në qoftë se mesatarja ka qenë 12 %, i bie që TVSH-ja paska funksionuar më shumë për ata që importojnë sesa për ata që e përdorin. Megjithatë, për të verifikuar nëse kemi bërë një politikë të saktë, e cila ka shkuar te fermeri, se qëllimi i Kryeministrit dhe i të gjithëve si maxhorancë ka qenë që zbritja e çmimit. Do të kërkoja nga ministria juaj që brenda të hënës, nëse arrini dot, në 10 apo 20 pika të bëni një referencë çmimesh sa ka qenë në vitin 2018, sa është në vitin 2019 dhe të merrni nga fermerët një kupon ose faturë që ata kanë blerë, në mënyrë që komisioni të verifikojë që politika fiskale që kemi ndjekur ka funksionuar apo jo në terren.

Ju përgëzoj realisht për rritjen e eksportit dhe promovimin e tij!

Faleminderit!

Zonja Gjylameti ka një pyetje.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Pyetjen e parë e kam në lidhje me lehtësimet apo politika të tjera incentivuese për produkte, të cilat janë të kërkuara në tregun ndërkombëtar. Shpesh në medie herë për të keqinformuar, herë nga padituria apo nga keqdashësia shikojmë që përdoren shumë fermerë, të cilët i hedhin në rrugë produktet e tyre, u tregojnë që nuk gjejnë treg në Shqipëri.

Pyetja ime është: cilat politika keni ndërmarrë apo si i keni lehtësuar marrëveshjet që nënshkruani ndërmjet shteteve të caktuara për të gjetur treg ndërkombëtar? Sikundër tha edhe kryetari, edhe nga ajo që ju treguat më pas me shifra, eksportet janë rritur, që tregon se funksionon, por do të doja të dija më tepër lidhur me marrëveshjet që nënshkruani, nëse ka të tilla dhe cilat janë politikat lehtësuese qoftë edhe në pjesën e informimit të fermerëve lidhur me produktet që duhet të prodhohen në Shqipëri dhe që kanë treg edhe jashtë saj?

Pyetja e dytë ka lidhje me rimbursimin e TVSH-së. Pak më parë kryetari i komisionit përmendi pjesën e zbritjes 10 %. Si ka funksionuar kjo edhe me eksportet? Dua të di nëse ka

shkuar ekzaktësisht aty ku sinonim nëpërmjet politikave fiskale të ndërmarra vitin që shkoi dhe si është pasqyruar kjo më tutje, te pika tjetër e zinxhirit, që është konsumatori?

Pyetja e tretë: meqenëse flasim për rritjen e eksporteve, por ndërkohë edhe për problematikat me procedurat doganore që kanë shpeshherë, çfarë masash ka marrë ministria juaj? Si ka bashkëpunuar me autoritetet doganore për të lehtësuar të gjitha procedurat doganore, sidomos kur për tregun europian ka disa afate të caktuara që duhen respektuar për të arritur në kohë produkti?

Pyetja e katërt është ajo temë që na prek të gjithëve besoj, që ju keni ndërmarrë një fushatë sensibilizimi, por jo vetëm, edhe fushatë kontrolli për sigurinë ushqimore. Do të doja të dija çfarë po bëjmë dhe cilat janë masat që do të merrni për vitin 2020 për sigurinë ushqimore dhe për të arritur jo vetëm thjesht te produkti përfundimtar që shkon në tryezën e gjithkujt, por edhe në fazat fillestare, që nga prodhimit deri në shitjen e produkteve?

Ju faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Lidhur me pyetjen e parë për problemet që ka fermeri për të shitur produktet e veta, ky ishte shqetësimi juaj pak a shumë nisur edhe nga ngjarjet e fundit për disa fermerë që ankohen për shitjen e tyre, mund t'ju them se, nëse ka pasur një sukses në rritjen e produktit bujqësor dhe drejtpërdrejt në rritjen e eksportit, kjo ka ardhur edhe për shkak të politikave që ka marrë qeveria, sepse ne e fokusuam dhe e orientuam ndihmën dhe politikën tonë në dy shtylla shumë të rëndësishme për produktin bujqësor që përmbledhet vetëm te fruta-perimet, jo përfshirjen e të gjithë sektorit të bujqësisë.

Përqendrimi dhe fokusi që u dhamë dy gjërave, nxitjes nëpërmjet mbështetjes së krijimit të serrave dhe forcimit të pikave të grumbullimit, ka qenë pikërisht një nga elementet kryesore të politikës sonë qeverisëse, që ka sjellë rritjen e produktit bujqësor dhe rritjen e eksporteve bujqësore. Pse? Sepse nëpërmjet serrave krijojmë një terren shumë të mirë konkurrues të produkteve shqiptare në rajon, dhe e dyta, nëpërmjet pikave të grumbullimit mundësojmë të gjejmë tregje të reja. Tregu është gjithmonë një koniunkturë që nuk varet drejtpërdrejt nga qeveria, por ne me politikat tona bëjmë të mundur që të sigurojmë...

Në qoftë se rrisim produktin që është konkurrent në tregjet rajonale që vijnë nga serrat dhe forcojmë pikat e grumbullimit, të cilat gjejnë tregje të reja, atëherë ia arrijmë qëllimit për të

në përgjithësi. Kjo, në fakt, ka rezultuar e tillë. Pra, i gjithë ky sukses ka ardhur më së shumti për shkak të politikave të drejta që kemi ndjekur në këtë aspekt.

Pa diskutim që çmimet janë edhe koniunkturë që nuk varen nga qeveria, por edhe nga planifikimi në fermë që mund të bëjë një fermer, sepse, siç tregoi vjeshta e këtij viti, një ngrohje e pazakontë e motit që vjen si pasojë e ngrohjes globale, solli që prodhimi në fushë të jetë shumë më i madh se ai që ka qenë, apo ai i parashikuari dhe bëri që prodhimi i serrës të piquej shumë më shpejt dhe menjëherë. Kjo solli që kishte një mbiprodhim edhe në rajon kryesisht të produktit të domates dhe uljen si rezultat i çmimeve. Kjo kaloi, sepse me ftohjen e motit filloi sërish avantazhi i produkteve të serrës dhe sot që flasim çmimet e domates kryesisht, meqë është një nga produktet e momentit, janë në majat e tyre.

Edhe në këtë aspekt qeveria ka çfarë të bëjë, sepse ne, nëpërmjet zyrave të këshillimit të ekstensionit dhe nëpërmjet pikave të grumbullimit, që janë hallka kryesore që lidhin prodhimin me tregun, duhet të këshillojmë fermerët për ciklet e prodhimit. Fjala bie, përveç ngrohjes globale, një nga problemet që u has këtë vjeshtë me produktin e domates ishte edhe planifikimi në fermë, u tentua mbjellja sa më shpejt e domates në mënyrë që ta vjelin në shtator për të lehtësuar serrën, sepse po ta mbjellin me kastravecën, i cili do të shitet në janar për të dalë prodhimi në shkurt kur çmimi është shumë i lartë, fermeri u nxitua dhe e mbolli domaten që në muajin korrik. Po të kishte dëgjuar këshillat dhe të kishte bërë një planifikim të mirë në fermë ta kishte mbjellë në gusht domaten, do të kishte filluar ta vilte atë në fund të tetorit dhe do të kapte një çmim shumë të mirë në treg.

Pra, janë elemente që ndikojnë në njëfarë mënyre, në kompleks pastaj në çmim dhe në produktin apo në avantazhin që do të krijosh me produktin në eksport.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Bledar Çuçi – Ishte edhe një pyetje tjetër, ajo për lehtësimin e procedurave doganore. Për sa u përket produkteve bujqësore, ne nuk kemi barriera, përveç kërkesave administrative që lidhen me certifikata fitosanitare apo tarifa të ndryshme, pra me taksat që aplikon vendi pritës, sikundër kemi barriera për sa u përket produkteve me origjinë shtazore.

Në lidhje me perimet, ne po e lehtësojmë fare tregun, pavarësisht nga një politikë më e gjerë që po ndërmerret qeveria dhe Kryeministri Rama në lidhje me shengenin ballkanik, që do t'i heqë fare kufijtë në rajon (dhe rajoni pa diskutim mbetet një mjedis shumë atraktiv për produktet shqiptare). Ne kemi filluar në mënyrë bilaterale që këto barriera t'i lehtësojmë me Kosovën dhe

me Maqedoninë e Veriut, si dy vende kufitare dhe ku qarkullon edhe më shumë produkti bujqësor për sa u përket dokumenteve administrative që kërkohen, që kryesisht janë certifikatat fitosanitare.

Në lidhje me produktet me origjinë shtazore, unë kam nënshkruar para tre muajsh në Kinë një marrëveshje për tri produkte shumë të rëndësishme, si: mjalti, djathi dhe vaji i ullirit. Nga dita në ditë presim të nënshkruhen protokollohet. Presim një delegacion nga Kina që të vijë të verifikojë fabrikat shqiptare, ku prodhohen këto produkte, që menjëherë pastaj t'u hapet rruga eksporteve të para. Paraprakisht janë lidhur kontrata me kompani kineze nga firma të ndryshme në Shqipëri.

Për sigurinë ushqimore...

Arben Ahmetaj – Jo, për sigurinë ushqimore patëm një diskutim, ku edhe ju ishit në krahun tonë, kur rrëzuam faljen e gjobave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju u shprehët me gjeeste, pra jo drejtpërdrejt, por gjestet ishin të mirëkuptuara.

Bledar Çuçi – U shpreha me votë.

Arben Ahmetaj – Votën e ke vullnet politik, nuk diskutohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, zonja Suzana!

Zonja Gjylameti bëri një pyetje për rimbursimet.

Bledar Çuçi – Në lidhje me uljen e TVSH-së 6%, sigurisht që në fillim pati një lloj, po themi, çoroditjeje për sa i përket ambientimit me regjimin e ri taksor. Unë mund t'ju them një gjë: ne morëm menjëherë masë për sa i përket pjesës së qumështit, sepse aty mund të ndihej drejtpërdrejt dhe, si të thuash, ndjeshmëria ishte shumë më e madhe për sa i përket çmimit me të cilin do të ballafaqohej fermeri në shitje në pikën e grumbullimit. Kështu që e subvencionuam menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë fermerin për çdo litër qumësht. Por unë mund t'ju them një efekt pozitiv që ka dhënë kjo gjë për sa i përket largimit gjithnjë e më tepër nga tregu të pikave të grumbullimit, që, në fakt, nuk kanë një rol pozitiv për tregun e produkteve bujqësore, por janë më shumë spekulantë, të cilët, në njëfarë mënyre, janë tërhequr nga tregu dhe u kanë lënë hapësirë atyre që, në fakt, punojnë dhe që e kanë orientimin më drejt, pikërisht nga fitimi i ndershëm, sepse gjithmonë ti nuk mund të paragjykosësh asnjë tregtar sa të fitojë ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por ka edhe sektorë të tjerë, që, në fakt, e kanë vuajtur në njëfarë mënyre dhe nuk kanë marrë subvencion drejtpërdrejt nga qeveria. Përmend këtu, për shembull, sektorin e bimëve medicinale, se edhe këto dalin në eksport. Ata kanë pasur një lloj luhatjeje për sa i përket trendit të rritjes së eksportit të bimëve medicinale. Kështu që ne po shohim mënyrën se si mund të ndikojmë me politika të tjera në lidhje me këtë gjë.

Arben Ahmetaj – Zoti Ministër, ju falënderoj edhe për sinqeritetin që treguat me komisionin, që e keni pasur në vazhdimësi, por i gjithë qëndrimi im për rimbursimin personal, po edhe si ish-ministër i Financave, ka qenë që rimbursimi duhet të ulet për tri arsye kryesore.

E para, subvencion i deformuar, dhe ju e korrighuat me një subvencion të drejtpërdrejtë te qumështi, siç e thatë, që, në këndvështrimin tim, është shumë korrekt për t'u bërë si subvencion.

E dyta, godiste drejtpërdrejt buxhetin.

E treta, furnizonte spekulantë, të cilët merrnin 20%-shin nga buxheti dhe nuk e çonin te fermeri.

Ndaj, realisht, ju falënderoj që vini si ministër sot dhe konfirmoni që këmbëngulja jonë për të ulur rimbursimin ka qenë e drejtë, në favor të fermerëve dhe të qytetarëve, si dhe e ka pastruar tregun e grumbulluesve nga spekulantët, ndërkohë ata që ngelen në treg janë njerëz që janë në të gjithë *network*-un e fermerëve, në mënyrë që ai 6% në finale shkon te fermeri, nuk rri te grumbulluesi, i cili do që të subvencionohet indirekt dhe në mënyrë shumë të deformuar nga buxheti i shtetit në kurriz të tatimpaguesve. Pra, kjo është shumë e drejtë.

Për sa i përket sherebelit ose jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ose bimëve medicinale. Këto bimë mund të kenë një logjikë subvencionimi, siç iu referuat, patjetër është gjykimi juaj dhe i qeverisë, ndërkohë ju kapët një element të rëndësishëm, që ishte rritja e eksporteve. Do të desha që një pyetje ta merrnit me vete, pra të mos i përgjigjeni sot: nëse eksporti i bimëve medicinale vazhdon normalisht, a do t'ia vlente të subvencionohet, ndërkohë që nuk është se ka probleme konkurrueshmërie? Ndoshta-ndoshta mund të mos më jepni asnjëherë përgjigje, por do të desha ta merrnit me vete për ta diskutuar brenda ministrisë dhe me Kryeministrin.

Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Do të marrim një pyetje nga opozita, një pyetje nga pozita, në mënyrë që të kemi edhe një balancë.

Ju lutem, zonja Suzana!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Ministër.

Bledar Çuçi – Në lidhje me pyetjen e parë, e kam një përgjigje. Në dhjetëmujorin e parë për produktet për bimë medicinale kemi një rritje prej 5,21%, krahasuar me vitin 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

5,21%.

(Kryetari i komisionit flet pa mikrofon.)

Për këtë më duhet të shoh të dhënat, por gjithmonë ka qenë një trend rritës, të paktën tre vjetët e fundit.

Arben Ahmetaj – ...dua t’i referohem me korrektesë fjalës suaj, që thatë se ka rënë ritmi i rritjes së eksporteve.

Bledar Çuçi – Po, ritmi ka rënë.

Arben Ahmetaj – Po patët mundësi, na e jepni ritmin e rritjes për këto katër vjetët e fundit.

Bledar Çuçi – Sepse, për shembull, në kilogram është e njëjta, ndërsa në vlerë është rritur me 5,21%.

Arben Ahmetaj – Atëherë, nuk është më çështje subvencionimi, por purifikisht çështje tregu, sepse i bie që sasi të janë të njëjta, që kanë rritur çmimin dhe këtu nuk kemi më problem kapacitetesh, përkundrazi, kemi problemin që tregu e kërkon me çmim më të lartë për shkak të ngushtësisë dhe specifikës së tregut. Kështu që do t’ju sugjeroja (është përgjegjësi juaja, që për bimët medicinale, që kanë këtë ritëm eksporti) që të mos i harxhojmë paratë e taksapaguesve shqiptarë për subvencion, por të shohim të subvencionojmë aty ku ju mendoni se ka një gjenerim dhe një nevojë për ta zgjeruar edhe më gamën e eksporteve. Ajo do të ishte... Megjithatë, ne e sugjerojmë nga komisioni, nuk është se është detyra juaj që ta vendosni.

Po, zonja Suzana.

Suzana Topi – Faleminderit, zoti Ministër!

Pa diskutim që bujqësia është baza e zhvillimit ekonomik të një vendi. Duke iu referuar vendit fqinj, Maqedonisë së Veriut, unë dua të bëj një pyetje lidhur me konkurrencën e

fermerëve tanë këtu në Shqipëri, pasi fermerët atje mbështeten me politika lehtësuese dhe prodhojnë prodhime me kosto më të ulët.

Pyetja e dytë: duke marrë shkas nga informacione të shpeshta që produktet ushqimore që ne konsumojmë kanë substanca të dëmshme për organizmin dhe jetën tonë, a është AKU-ja autoriteti përgjegjës për të na siguruar cilësinë e produkteve ushqimore që ne konsumojmë?

Pyetja e tretë: duke iu referuar protestave të fermerëve, a do të ketë subvencionime të karburantit për përdorim në bujqësi për t'u subvencionuar?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zoti Ministër, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë se erdhe, Vullnet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që ju keni dhjetë pyetjet e fundit!

(Ilaritet në sallë)

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me pyetjen e parë për krahasimin me Maqedoninë e Veriut, sigurisht ky vend ka paketën më të madhe mbështetëse në rajon dhe aplikon më së shumti mbështetjen direkte te fermeri. Por unë dua të them një gjë si ministër i Bujqësisë dhe si përgjegjës për politikën e bujqësisë: gjithnjë e më tepër, dhe kjo është e konfirmuar edhe nga një studim i bërë nga një ekspert i FAO-s, që shumë shpejt do të kem versionin përfundimtar dhe mund t'ju u shpërndaj edhe juve si komision. Konkluzioni i këtij eksperti është që në të gjithë Europën, në fakt, po hiqet gjithnjë e më tepër dorë nga mbështetja direkte. Rritjen e qëndrueshme të sektorit bujqësor e garanton mbështetja në pjesë e sektorit që krijon vlerë dhe qëndrueshmëri në rritjen e sektorit.

Ka një fakt, që do të ishte edhe një përgjigje imja në lidhje me këtë gjë, për sa i përket krahasimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërisë. Unë mund t'ju them se, nisur nga fakti që rritja e eksporteve të prodhimeve bujqësore shqiptare është më e madhe dy vjetët e fundit sesa rritja e eksporteve të prodhimeve bujqësore maqedonase. Ky nuk është i drejtpërdrejtë, por është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – A mund ta përsërisni këtë, zoti Ministër, sepse ky është thelbi që kemi kaq vite që e themi?

Bledar Çuçi – Pa vajin e hashashit, sepse...

Arben Ahmetaj – Lëre vajin e hashashit, se është politikë e re dhe specifike! Mos iu refero asaj! Të lutem, edhe një herë, që të gjithë të paditurit e bujqësisë që bëjnë sikur e mbështesin këtë të fundit, ta kapin këtë, dashtë Zoti!

Bledar Çuçi – Pra, trendi rritës i eksporteve të produkteve bujqësore shqiptare është më i lartë sesa rritja e eksporteve të produkteve bujqësore maqedonase.

Arben Ahmetaj – Shumë faleminderit, Ministër! Kjo do të thotë se subvencionet janë populiste në disa raste...

Bledar Çuçi – Në disa raste, po.

Arben Ahmetaj – ...sepse ka subvencione që shkojnë direkt te rrënja e bimës në kuptimin e mirë, por ka edhe subvencione, ja ku është fakti, që thotë ministri, se raporti i eksporteve dhe raporti i eksport me import...

Faleminderit, zoti Ministër, që ma konfirmuat të gjithë betejën time shumëvjeçare!

Bledar Çuçi – Dhe është një debat, në fakt, i politikëbërësve sot në të gjithë Europën, madje edhe brenda Brukselit, nëse duhet të vazhdojë të harxhojë ose jo Brukseli kaq shumë lekë për mbështetjen ndaj fermerëve; është një debat i hapur edhe sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Qetësi, se duhet të mësojmë nga ministri! Janë mësimet 101 të bujqësisë; t'i mbajmë shënim! Kush nuk i di, t'i mbajë shënim, pasi janë shumë të rëndësishme: raporti eksport – subvencion, raporti i ritmit të eksporteve me subvencionin tregon efektivitetin e politikave dhe largimin e domosdoshëm nga politikat populiste!

Bledar Çuçi – Ne duhet të harxhojmë para publike aty ku krijojmë vlerë, ku kemi avantazh.

Në lidhje pastaj me shpenzimin e parasë publike thjesht për lëmoshë, kjo është një politikë aspak moderne dhe që, në fund të fundit, nuk garanton kurrësi rritjen e sektorit. Çfarë dua të them me këtë? Dua të them që, pa diskutim, mbështetjen direkte do ta vazhdojmë për disa pjesë të sektorit, pasi kemi ende nevojë të rrisim sektorë, që, në fakt, duke qenë se Shqipëria ka potenciale...

Arben Ahmetaj – Më falni, kam nevojë për qetësi ju lutem, që të dëgjojmë ministrin!

Bledar Çuçi – Duke qenë se Shqipëria ka shumë potenciale për të krijuar avantazhe në tregje siç është sektori i blegtorisë për të imtat, pasi vendi ynë ka nga kullotat më të mira të

rajonit dhe ka akoma shumë kullota të pashfrytëzuara, pa diskutim që ne do të vijojmë ta orientojmë në disa pjesë të sektorit mbështetjen direkte, por duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të mos e marrim si diçka *for granted*, që ne duhet të mbështesim çdo fermer për çdo situatë dhe për çdo produkt. Kjo është shumë e rëndësishme për të orientuar ato pak para publike që kemi (se në krahasim me Europën ne jemi vend i varfër), dhe t'i çojmë për forcimin dhe rritjen e qëndrueshme të sektorit aty ku ne krijojmë vlerë dhe në eksport, pra aty ku produktet shqiptare pranojnë nga tregjet e huaja. Me tregun shqiptar, kaq të vogël sa e kemi, kurrë nuk bëjmë dot një sektor që të krijojë qëndrueshmëri dhe rritje, pasi jemi treg shumë i vogël. Po që se nuk dalim në eksporte nuk do të krijojmë dot kurrë një sektor bujqësor që të jetë motor për ekonominë dhe për mirëqenien e shqiptarëve.

Atëherë çfarë duhet të bëjmë? Duhet të çojmë produktet shqiptare. Çfarë duhet të bëjmë këtë rast? Duhet të dimë se cilat nga produktet bujqësore krijojnë avantazh me burimet natyrore e njerëzore që ka Shqipëria në tregjet europiane. Ky është orientimi i politikave tona.

Arben Ahmetaj – Zoti Ministër, ju faleminderit për qartësinë!

Ajo që ju theksuat në lidhje me subvencionin në raport me eksportin, me subvencionin në raport me ato kategori, që kanë vlerë dhe subvencionit si element populist në raport me politikën e brendshme apo me zgjerimin e tregut përmes eksportit janë të vlefshme, prandaj do t'ju lutesha në emër të komisionit që t'i përsërisni sa më shpesh, në mënyrë që politikat fiskale dhe politikat subvencionuese të mos shpërbëhen në drejtim të populizmit. Ne jemi forcë e majtë dhe nuk kemi nevojë të bëjmë populizëm të majtë, sepse ne japim mbështetje për kategoritë në nevojë dhe për sektorët që prekin gjerë komunitete. Elementi i subvencionit të qumështit, që i referoheni ju, ka nevojë gjithashtu për një analizë, për të vërtetuar për veten tuaj për buxhetin e shtetit, për politikën e nënsektorit, nëse vlen, çfarë vlen dhe çfarë solli. Raporti një njësi subvencionimi me një njësi eksporti ose 10 njësi subvencionimi me një njësi eksporti tregon efektivitetin e politikës së subvencioneve. Po që se bëni një vlerësim të politikës suaj dhe e ndani me ne për subvencionimin e qumështit apo për logjikën e subvencionimit kategorie ose nënkategorie, do të vrente për të rritur dijen e gjithkujt, si dhe efektivitetin e politikave, në një nivel tjetër.

Faleminderit!

A ka pyetje tjetër?

Bledar Çuçi – Më fal, por kam për t'iu përgjigjur edhe pyetjes për karburantin.

Pyetja ishte: a është AKU-ja përgjegjëse për cilësinë e produkteve në fermë? Nuk është vetëm AKU-ja, AKU-ja është përgjegjëse kur del nga ferma. Pa diskutim që tregu i prodhimeve bujqësore në këtë mori të madhe fermerësh (se ne e kemi shumë të fragmentuar pjesën e prodhimit bujqësor, pasi edhe toka bujqësore është e fragmentuar, fenomene që i dimë të gjithë), ka edhe spekulantë, të cilët të prirur nga fitimi i shpejtë spekulojnë me prodhimin bujqësor dhe me rritjen e tyre. Unë do t'ju them një gjë: ne kemi një strategji të qartë për kontrollin e tyre dhe për këtë arsye, një nga instrumentet që po përdorim së fundmi është të fusim në lojë edhe grumbulluesit, për të kontrolluar prodhimin që del në treg. Ky është një instrument shumë efikas, sepse grumbulluesi ka në patronazh një numër shumë të madh fermerësh, dhe duke kontrolluar grumbulluesin kontrollojmë një numër shumë të madh fermerësh.

Sot në Shqipëri ka grumbullues që kanë nga 2500 deri në 3000 fermerë në kontratë, pra që u marrin produktin, dhe këta fermerë janë të interesuar të kenë një lidhje të qëndrueshme me grumbulluesit. Duke shkuar për të bërë kontrollin me grumbulluesit ne garantojmë 100% produktin, që del drejtpërdrejt nga ferma dhe shkon në treg nëpërmjet grumbulluesit.

Ka raste abuzimi me përdorimin e plehrave kimike dhe ne jemi përpjekur që t'i frenojmë sa më shumë, por po ju them, jo vetëm juve si komision, por të gjithë atyre që na dëgjojnë, se 99% e produkteve bujqësore shqiptare janë të garantuara për sa u përket kriterëve që lidhen me sigurinë ushqimore për njeriun. Ky është një fakt absolut. Na prishin gjithmonë punë këta 1 përqindësat, për fat të keq ndonjëherë edhe media, e prirur nga sensacioni, marketon më shumë të keqen sesa të mirën.

Të marrim edhe një fakt tjetër për ta përforcuar argumentin në lidhje me këtë gjë. Në eksport, vetëm 1% na janë kthyer me ngarkesë më madhe.

Arben Ahmetaj – Ministër, a mundet që për të gjithë pjesën e eksportit dhe të produktivitetit të eksportuesve, të fermave që destinohen për eksport, për të gjithë pjesën e sigurisë dhe cilësisë ushqimore të eksportit të bëni një fushatë? Nëse keni nevojë për pak më shumë para për fushatën, ja ku jemi duke bërë buxhetin, sepse është shumë e rëndësishme për fermerët për fermat, për imazhin e Shqipërisë, për cilësinë e produkteve, për rritjen e eksportit.

Do t'ju lutesha dhe do t'ju sugjeroja, të bëni një marrëveshje pozitive shumë transparente me median për promovimin e produkteve shqiptare. Sigurisht që aty ku ka probleme media do t'i evidentojë, se në finale është kritika ajo që korrekton. Nëse nga 99% 1% është problematikë,

atëherë të fokusohemi te përmirësimi i saj dhe të promovimi i 99 përqindëshit, por edhe i të gjithë atyre jetëve, fermave, apo grumbulluesve që janë të lidhur me këtë sukses.

Nëse keni nevojë për mbështetje financiare, ejani ta diskutojmë në komision kur të vijë puna nen për nen dhe t'ju ndihmojmë se kjo është shumë dinjitoze, shumë ekonomike, patriotike dhe ndihmon të gjithë zinxhirin!

Faleminderit, zoti Korab!

Bledar Çuçi – A mundem, zoti kryetar?

Arben Ahmetaj – Patjetër, zoti Ministër, sa herë të doni!

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Pashë disa nga konkluzionet paraprake të ekspertit, por për Komisionin e Ekonomisë mund të ketë vlerë, e kam fjalën për *value added in agriculture*, dhe nga eksperti rezulton që në Shqipëri, për çdo njësi monetare, dhe në rastin konkret ai ka marrë dollarin, e hedhur në sektorin e investimeve kjo *value added* rritet me 5 dollarë për çdo njësi. Kjo tregon që subvencionimi në investime, për t'ju thënë shkencërisht, ka impakt të konsiderueshëm makroekonomik.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, i dashur!

Ne subvencionojmë investimin për të zgjeruar bazën e prodhimit, nuk subvencionojmë andej-këndej kot. Faktikisht kjo është ajo, të cilës ne i referohemi si *value chain*, pra si krijohet zinxhiri i vlerës.

Këtë ndaje me ne në komision, ose me qeverinë, sepse do të vlejë shumë. Një dollar subvencionim në investim sjell 5 dollarë vlerë të shtuar, pastaj mund ta detajojmë nëse është 1 dollar investim në entitet, në fermë, apo në makineri. Kjo është e rëndësishme, se përndryshe na ngushton fokusin e efektivitetit.

Zoti Korab, ishte një përfaqësues i pozitës, por po ju konsideroj si përfaqësues i kryesisë së opozitës.

Fjala për ju.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për prezantimin, zoti Ministër!

Sigurisht që prezantimi me kaq vullnet dhe në objekt të punës suaj na bën të ndihemi mirë këtu, por kur dalim në terren ka një realitet tjetër! Kundrejt asaj që ndjejmë ne, nuk e di se si do të ndihet fermeri, i cili sapo ka hedhur prodhimin e tij, ose nuk shton dot krerët, por këtë

problem nuk e zgjidhni dot ju, sepse është një problem i trashëguar, bujqësia shqiptare është një problem shumë i madh, ku ju po mundoheni të vendosni tullën tuaj dhe ju përgëzoj për këtë.

Unë kam një pyetje konkrete për sektorin e blegtorisë. Çfarë politikash lehtësuese financiare, apo subvencionime, në drejtim të shtimit të krerëve keni planifikuar për vitin 2020? Çfarë politikash lehtësuese keni planifikuar për fermerët, të cilët duan të ndërtojnë në fermat e tyre, si objekte strehuese për bagëtitë, punishtet, fabrikat, pra sipas profileve të ndryshme? Unë kam shembuj konkretë që ka burokracia të tipit që fermeri aplikon në bashki (pasi ajo ka kompetencën për një stallë, për leje ndërtimi) dhe e sorollatin. Pjesa e blegtorisë është shumë e ndjeshme, sidomos kur vjen dimri.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ju lutem, zoti Ministër!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me politikat lehtësuese për sektorin e blegtorisë, ju thashë që vetë sektori i blegtorisë, pra të gjithë fermerët e këtij sektori, do të marrë mbështetje të drejtpërdrejtë nga skema kombëtare e mbështetjes dhe këtë gjë do ta bëjmë duke përdorur skemën më direkte, pra subvencionin për tufë.

Është skemë e thjeshtë dhe është mirëpritur gjerësisht nga gjithë fermerët. Kjo gjë do të garantohet me buxhetin e vitit 2020.

Vitin që kaloi dhamë për qumështin dhe për shkak të mbështetjes që do të jepnim për litër qumështi patëm pakënaqësi tek-tuk, por këtë vit garantojmë që do të japim për tufë, pra subvencionim për matrikull.

Për sa u përket politikave për ata që duan të investojnë gjithmonë në sektorin e blegtorisë, skema e IPARD-it, e di që do të thoni që IPARD-i është i vështirë për t'u arritur, favorizon të gjithë ata që duan të bëjnë stalla. Ndërkohë që flasim është e hapur thirrja dhe mbyllet më 16 dhjetor, por për të gjithë aplikantët që duan të investojnë në sektorin e bujqësisë sipas 3 masave që tashmë dihen. Një nga masat përfshin edhe mbështetjen deri në 60%, me sa di unë të investimit si grant për fermerin që do të investojë. Në rastin konkret edhe për stallat kjo gjë është e hapur edhe për makineritë bujqësore.

Për pjesën e burokracive administrative, unë personalisht kam marrë disa iniciativa. Për shembull, u kam dhënë të drejtë kryetarëve të bashkisë nëpërmjet KKT-së që është organi qendror i planifikimit të territorit në Shqipëri që pa pasur nevojë të vijnë në ndryshojnë planin

rregullues që e kanë miratuar dhe nuk kanë parashikuar për shumë arsye një stallë apo një investim në bujqësi, që ata drejtpërdrejt ta bëjnë këtë gjë, pa ardhur në KKT. Ky është një lehtësim goxha i madh. Ndërkohë që për dokumente që kërkohen nga agjencitë qendrore, që varen nga qeveria kemi një rrugë të shpejtë për ata që duan të investojnë dhe që duam të përfitojnë nga subvencionet, të cilat vijnë qoftë nga skema kombëtare apo nga ajo e IPARD-it, pra leje mjedisore, të gjitha lejet që janë burokratike.

Në vitin 2020 të gjitha këto kërkesa që do të bëhen për leje të kësaj natyre do të jenë të gjitha *online*. Nuk do të ketë më takime sy në sy me zyrtarin, i cili për arsye nga më të ndryshmet mund t'ia zvarrisë ato apo mund t'ia pengojë që në fazën e bërjes së aplikimit. Çdo aplikim do të jetë *online*. Afatet ligjore janë atje dhe do të jetë shumë e qartë, nëse e fiton apo jo. Në bazë të parimit, miratimit të heshtur do ta përfitojë, nëse nuk i kthen përgjigje administrata.

Arben Ahmetaj - Faleminderit, zoti Ministër!

Zonja Dhima, do t'ju lutesha që pyetja të jetë koncize!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër për prezantimin e prioriteteve dhe synimeve që do të ketë ministria juaj në buxhetin e vitit 2020!

Ju falënderoj për punën, angazhimin tuaj dhe rezultatet e arritura gjatë vitit 2019!

Ju komplimentoj për aktivitetin e organizuar në fundjavën e kaluar “Shqipëria punon tokën”, një aktivitet, i cili i ngjante një ferme të ndërtuar në qendër të Tiranës.

Ju uroj suksese në aktivitetin në këtë fundjavë “Mandarina fest”!

Le të kthehemi te buxheti. Një nga prioritetet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është garantimi i sigurisë ushqimore, si dhe mbrojtja e konsumatorit. Ajo që dua të di nga ana juaj në lidhje me këtë problem shumë të rëndësishëm për shëndetin e konsumatorëve është: a janë të licencuar laboratorët e kontrollit ushqimor në nivel qarku? A keni parashikuar fonde në buxhet për trajnimin e inspektorëve të AKU-së, blerjen e pajisjeve të laboratorëve ushqimorë, blerjen e autovekurave, të cilat duhet të jenë në dispozicion të inspektorëve për të kryer detyrën e tyre? Sa ka qenë numri i bizneseve të mbyllura deri tani nga AKU-ja për arsye të mosplotësimit të kushteve të sigurisë ushqimore, si një nga sfidat që ka qeveria shqiptare? Sa ka qenë numri i rasteve të ngarkesave të kthyer në pikat e inspektimit kufitar?

Arben Ahmetaj – Pyetje..

Antoneta Dhima - Pyetje ishte. Janë disa pyetje.

Zhvillimi rural është një nga prioritetet e ministrisë suaj, që synon rritjen e numrit të fermerëve që përfitojnë nga skema mbështetëse, si dhe shtimin e sipërfaqeve të mbjella me fruta dhe perime.

Arben Ahmetaj - Zonja Dhima, bëni pyetjen!

Antoneta Dhima - Pyetja është: sa është numri i fermerëve që kanë përfituar për këtë vit nga skemat mbështetëse? Sa janë shtuar sipërfaqet e mbjella me fruta dhe perime sipas informacionit që keni si ministri?

E fundit, ministria juaj ka në administrim edhe hidrovolet. Strukturat dhe burimet njerëzore të tyre përcaktohen nga ana e ministrisë suaj. Sipas informacionit që kam ka disa mungesa në plotësimin me strukturë të hidrovoletëve, a keni parashikuar në buxhetin e vitit 2020 plotësimin e këtyre strukturave?

Arben Ahmetaj - Ju lutem, zoti Ministër!

Bledar Çuçi - Faleminderit, zoti kryetar!

Janë pyetje që lidhen me statistika që duhet t'i kem përpara që të mos spekuloj dhe të jem sa më i saktë.

Në lidhje me pyetjen e parë që ka të bëjë me forcimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, e thashë që në vitin 2020 ne do ta ristrukturojmë totalisht këtë autoritet, edhe për shkak të fuzionit që do të bëjmë me Inspektoratin Shëndetësor, ku do të marrim edhe 15 mijë subjekte të tjera që do t'i kemi në nën mbikëqyrje për t'u kontrolluar. Ne do të bëjmë një strukturë konceptuale komplet tjetër.

Arben Ahmetaj - Më fal, zoti Ministër!

Zonja Dhima, çfarë kishit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, mos e ndërprisni ministrin, por çfarë kishit konkretisht!

Nuk ju kuptoi ministri?

Bledar Çuçi - Për trajnimin e punonjësve. Këtu po dal.

Për numrin e subjekteve të mbyllura duhet të marr një informacion të saktë. Do t'jua çoj shumë shpejt, sepse informacioni ekziston, brenda ditës së sotme, nëse ju do të jeni ende këtu. Do t'jua çoj të gjitha statistikat që kërkuat.

Numri i fermerëve të subvencionuar drejtpërdrejt, pra pyetja tjetër, këtë vit ka qenë rreth 5000. Këtu përsëri kthehem te logjika dhe politika që kemi ndërmarrë.

Në gjithë historinë e këtyre viteve të tranzicionit numri i fermerëve të mbështetur drejtpërdrejt nuk ka qenë asnjëherë më shumë se 11 mijë. Kjo tregon që, sado të përpiqemi të mbështesim drejtpërdrejt fermerët, kurrë nuk do të arrijmë horizontalisht mbështetjen e tyre. Prandaj, ne fokusohemi në pjesët që krijojmë, pra që paranë publike ta shpenzojmë për të krijuar atë që thamë, vlerën e shtuar.

Të mos harrojmë: numri më i lartë ka qenë 11 mijë fermerë, ndërkohë që vetëm të formalizuar 100% kemi 40 e ca mijë fermerë, për të mos thënë që numri i fermerëve, duke shtuar fermerët e vegjël, shkon në 250-300 mijë. Pra, kjo përforcon akoma më tepër argumentin tonë se duhet të fokusojmë politikat tona mbështetëse në ato pjesë të sektorit ku krijojmë vlera dhe avantazhe.

Për strukturën e hidrovoreve nuk di të kemi mangësi që përbëjnë problem, por, gjithsesi, siç jua thashë, kemi parashikuar një buxhet specifik vetëm për hidrovolet në 2020-n.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Drejtori po më thotë se ka nevojë vetëm për dy-tri rregullime të brendshme, që mund t'i bëjmë me burimet që kemi brenda për brenda.

Arben Ahmetaj – Qartë.

Faleminderit, zoti Ministër!

Bledar Çuçi – Statistikat do t'ju sjell të gjitha sipas...

Arben Ahmetaj – Edhe *spreadsheet*-n për çmimet e inputeve.

Bledar Çuçi – Po, i morëm shënim.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, me përgjegjësi zyrtare, sepse do të bëjmë edhe një verifikim tonin!

Person m – Po bëjmë një *abdate*-im të fundit.

Arben Ahmetaj – Bëjeni për ne, ju lutem! Të hënën ta kemi, që t'i referohemi.

Faleminderit!

Po, zonja Lala.

Reme Lala – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse jeni i pranishëm, zot Ministër, dua të shfrytëzoj rastin për t'ju përcjellë një shqetësim real të bletarëve, duke marrë shkas nga diskutimi që kam pasur me ta. Problemi i tyre

konsiston në faktin që u shitën produkte jo të certifikuara, duke shkaktuar probleme me mbetjet, që më pas rezultojnë në mjaltë. Ky problem le të shërbejë ndoshta edhe si një sugjerim për të ndërmarrë masa konkrete për kontrollin e produkteve që shiten për mirëmbajtjen e bletëve.

Mendoj se duhet t'i kushtoni vëmendje dhe interes të veçantë kësaj fushe, pasi është me shumë rëndësi për rritjen e ekonomisë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Kemi edhe dy deputetë që duan të bëjnë pyetje, Xheviti dhe Vullneti. Xhevit, bëj pyetje direkte, jo...

Xhevit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Pyetja ime konsiston në shqetësimin që kanë fermerët e zonës së Fierit dhe në përgjithësi për buxhetin e planifikuar për investime në drejtimin e lumenjve, duke ndërhyrë në to me tërheqjen e materialit dhe në drejtimin e rrjedhës së lumenjve, me penelet dhe pyllëzimin e shtratit të lumenjve. Nuk e di si janë planifikuar këto në buxhetin e vitit 2020.

Njëkohësisht, duke vlerësuar maksimalisht punën që është bërë për ujitjen...

Arben Ahmetaj – Zot Xhevit, të lutem...!

Xhevit Bushaj – Urdhëro!

Arben Ahmetaj - Pyetjen, i dashur!

Xhevit Bushaj – Doja të dija fondet e planifikuara për ujitjen me ngritje mekanike dhe sidomos ato ku me kryerjen e një investimi për infrastrukturën kemi dëmtuar edhe veprat ujitëse, siç është kanali i ujitjes së fushës së Cakranit, që ju, zoti Ministër, e keni inspektuar vetë dhe e dini si është situata. 1800 hektarë tokë, për shkak të një sifoni, nuk ujitën.

Dua të pyes se ku janë procedurat për kalimin e disa aseteve të veprave ujitëse, që deri më sot qëndrojnë asete të bordeve të kullimit, kur ato u shërbejnë fermerëve në juridiksionin e bashkisë dhe mund të jenë në dispozicion të bashkive për një administrim më të mirë të ujitjes.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Xhevit!

Ju lutem, zoti Ministër, përgjigjuni!

Xhevit Bushaj – Vlerësoj masën e ndërmarrë edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, por edhe propozimin e bërë nga ky komision, për heqjen e TVSH-së tek inputet bujqësore. Unë jam

dëshmitar, e kam verifikuar dhe i ndiej efektet e heqjes së TVSH-së te çmimi i këtyre imputeve, që u shiten direkt fermerëve. Megjithatë, vëmendja nuk duhet të mungojë edhe në të ardhmen...

Arben Ahmetaj –Zoti Xhevit, të lutem! Më fal, një sekondë! Kur them bëni pyetje dhe ju vazhdoni me këto... Nuk do t'ju lejoj të vazhdoni me komentet tuaja. Ju lutem, se i bie të bëjmë një rrëmuje që të mos mbarojë kurrë!

Xhevit Bushaj – Ne nuk bëjmë rrëmuje, por ngremë problematika.

Në fund të fundit, kjo që po them duhet vlerësuar, sepse tek insekticidet kërkohet një vëmendje më e shtuar nga të gjitha dikasteret, në mënyrë që të japë efekte te fermeri...

Arben Ahmetaj – Të lutem, tani!

Xhevit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Xhevit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Për pjesën e mbrojtjes nga përmytja dhe për zonën tuaj, i nderuar deputet, mund t'ju them që vetëm sivjet kemi bërë 4-5 ndërhyrje me penele në lumin e Vjosës, që janë shumë të rëndësishme, sidomos për zonën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka rëndësi.

Në 2020-ën nga 2,1 miliardë lekë investim të brendshëm, 1 miliardë lekë do të shkojnë për mbrojtjen nga përmytja. Sigurisht, nuk është vetëm Vjosa, sepse kemi edhe Bunën, Shkumbinin, Osumin, Devollin, Drinin e Zi, Drinin e Lezhës, Kalasën e kështu me radhë.

Xhevit Bushaj – Në materialin që na keni paraqitur Vjosa nuk përmendet fare, prandaj u detyrova...

Bledar Çuçi - Është.

Xhevit Bushaj – Unë nuk e kam gjetur.

Bledar Çuçi – Pa diskutim që është.

Për asetet, të them të vërtetën, nuk kam ndonjë informacion të saktë se çfarë kërkohet nga transferimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo është në bisedime me kryetarin e bashkisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...sepse ne nuk duam t'i lëmë një hall kryetarit të bashkisë, por duam të planifikojmë edhe një investim atje, në mënyrë që kur ta marrë të ketë një vlerë për gjithë bashkinë. Këtu përfitoj nga rasti për t'ju thënë që Bashkia e Fierit është modeli se si duhet të orientohet çdo bashki në zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zoti Vullnet, do t'ju lutesha të kaloni direkt te pyetjet!

Vullnet Sinaj – Ne dy fjalë do t'i themi, se nuk kemi si t'i lidhim pyetjet. Të bëjmë vetëm pyetje, duket si anormale.

Arben Ahmetaj – Mirë. Atëherë, mbylleni pak mikrofonin, ju lutem!

Media, dua dy minuta pushim.

Vullnet, ju lutem!

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Zoti Ministër, shikoj një angazhim të madh nga ju për përmirësimin e bujqësisë, por bujqësia është me të vërtetë industria pa çati dhe ka shumë e shumë probleme, prandaj do të bëjmë shumë pyetje.

Ministrja e Financave, në raportimin që bëri në Komisionin e Ekonomisë, tha se ka parashikuar 850 milionë lekë për skemat në bujqësi.

Pyetja e parë është: si mendoni ju, a janë të mjaftueshme këto për të përballuar subvencionin e bujqve në konkurrencën e tregut në rajon?

Në fjalën tuaj ju thatë se nga raportet e eksportit dhe importit me Maqedoninë është në rritje eksporti shqiptar, me përjashtim të vajit të hashashit. Apo e kam gabim? Kështu thatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, përse duhet ta lëmë “me përjashtim të vajit të hashashit”? A mendoni se mund të ketë ardhur koha që edhe ne të nxisim në sektorin bujqësor prodhimin...?

A kemi import për vajin e hashashit nga Maqedonia në Shqipëri?

A mendoni që edhe ne në Shqipëri duhet ta stimulojmë prodhimin e këtij produkti për mjekësinë?

Pyetja tjetër: a keni parashikuar matrikullimin e bagëtive falas në vitin 2020?

Në prioritetet e 2020-ës ju thoni se do të nxisni tregun e tokës.

Si do ta nxisni tregun e tokës, kur dimë që ka akoma toka të paazhurnuara në Shqipëri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni në prioritetin e vitit 2020 nxitjen e tregut të tokës.

Arben Ahmetaj – Ndërkohë që azhurnimi akoma nuk ka përfunduar.

Faleminderit!

Vullnet Sinaj – Ju thoni se rritja e numrit të certifikatave të unifikuara për eksport, nga 18 në vitin 2019, do të shkojnë në 40 në vitin 2022. Sa është numri total i këtyre certifikatave që të marrë fund certifikimi i produkteve bujqësore dhe ne të kemi sa më shumë eksporte?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e lexoj: “Rritja e numrit të certifikatave të unifikuara për eksportet, nga 18 në vitin 2019, në 40 në vitin 2022”. Pyetja ime është: sa është në total numri i certifikatave, që u duhen produkteve bujqësore, që të marrë fund certifikimi i tyre?

Arben Ahmetaj – Ministria, kur të përgjigjeni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, Xhavid mbani qetësi!

Kur ju bëtë pyetje, të gjithë ju dëgjuan me vëmendje. Të dëgjojmë Vullnetin.

Vullnet Sinaj – Ministria e Bujqësisë bën vaksinimin e bagëtive për sëmundje të ndryshme në zona të ndryshme.

Ka ardhur një informacion nga fermerët, që bagëtisë shtegtojnë dhe kërkohet vaksinimi edhe në zonat e tjera. A mund të bëni vaksinim të bagëtive në të gjithë territorin?

Vitin e kaluar, nga skemat e subvencioneve të blegtorisë ngeli një numër i madh i blegtorëve pa u financuar. Zoti Ministër, a ekziston mundësia që, këtë vit, nga subvencionet, të fillojmë atje ku ndaloi numri vitin e kaluar, që të i inkurajojmë këta blegtorë të aplikojnë për skemat në bujqësi? Kjo është këshillë imja, që ju ta filloni numrin aty ku ndaloj, dhe të mos i rihapni numër tjetër, sepse, ata që janë të zhgënjyer nga viti i kaluar, nuk do të aplikojnë këtë vit.

Faleminderit, kryetar!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, Vullnet!

Ju lutem, Ministër!

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Për shumën që është akorduar në mbështetje të sektorit në vitin 2020, e cila shkon rreth 850 milionë lekë, unë ju thashë se sa më shumë të kemi në dispozicion, aq më mirë do të ishte, por, siç e paraqita edhe në komision, për ne është e rëndësishme që këto para të shpenzohen aty

ku kanë vlerë. Pa diskutim që ministri i Bujqësisë, si çdo ministër apo përgjegjës për një politikë të caktuar, nuk do t'i thoshte "jo" një shume të madhe që do të akordohej nga buxheti publik. Kjo është tërësisht e natyrshme. Unë mund t'ju them se pa diskutim do të bëjmë më të mirën me paratë që kemi në dispozicion, duke ndërhyrë në pjesët e sektorit që kanë vlerë, për të garantuar një rritje të qëndrueshme të sektorit në përgjithësi.

Për importin e vajit të hashashit apo në përgjithësi për politikën për ta lejuar edhe këtu, kjo nuk është pyetje për mua, sepse është një politikë më e gjerë, që duhet ndërmarrë, nëse ka ardhur koha për ta bërë këtë gjë.

Për ta saktësuar, unë krahasova trendin rritës të eksporteve të produkteve bujqësore maqedonase, pa vajin e hashashit, me tregun rritës të eksporteve të produkteve shqiptare. Këtu e kisha fjalën, kur thashë që trendet tona janë më në rritje se ato maqedonase.

Për matrikullimin falas, unë dua ta bashkoj përgjigjen edhe me vaksinimin në të gjithë territorin për bagëtitë. Këtu do të bëjmë një përmbysje për vitin 2020. Ne kemi hartuar ligjin e ri për veterinarinë, duke parë që deri më sot ka dështuar skema se si e kemi organizuar shërbimin veterinar, kryesisht me futjen e klinikave veterinare, që na rezulton se nuk po e mbulojmë dot, jo vetëm siç duhet, shërbimin veterinar, por edhe të shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për këtë arsye ne do ta sjellim shumë shpejt një ligji në qeveri, i cili do të vijë për t'u miratuar në parlament brenda dhjetorit. Ne do të riorganizojmë komplet shërbimin, duke ngritur një shërbim piramidal, me një kokë, me një kryeveteriner të Shqipërisë dhe të shtrirë në të gjithë territorin e Shqipërisë. Matrikujt i kemi, sepse i kemi blerë këtë vit, dhe pasi të ngrihet piramida, matrikullimi do të bëhet falas nga veterinerët e shërbimit veterinar të Shqipërisë. Matrikujt i kemi blerë me paratë e vitit 2019 dhe një pjesë të tyre ua kemi dhënë klinikave veterinare për matrikullimin gjatë vitit 2019.

Tregu i tokës dhe azhurnimi pa diskutim mbetet ende si problem. Ndërkohë, ne duhet të miratojmë edhe ligjin e fundit, që do ta përfundonte të gjithë pjesën e procedurave të kalimit të pajisjes me certifikatë pronësie të tokave bujqësore, por mbetet gjithmonë një problem i kahershëm, problemi më i madh i Shqipërisë i krijuar në këto 30 vjet. Të mos harrojmë që qeveria jonë i ka dhënë drejtim zgjidhjes përfundimtare të kësaj çështjeje. Kjo çështje ka qenë e braktisur nga të gjitha qeveritë, si një gjë që nuk i afrohej asnjë, sepse ishte sikur djalli t'i afrohej temjanit. Besoj se me ligjin e ri, pas konsultimeve me Komisionin e Venecies për disa çështje kushtetuese, pritet ta miratojmë shumë shpejt për të dhënë një përgjigje përfundimtare.

Për certifikatat nuk ka një numër të fundëm. Ne thamë se do ta çojmë ... Sa e kemi sot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta çojmë në 40 numrin. Kjo është një rritje shumë cilësore për sa i përket standardit, që do të ndikojë pozitivisht në qarkullimin e mallrave dhe të produkteve bujqësore shqiptare.

A mund të fillojë subvencioni sivjet aty ku ka ndaluar? Ky është një sugjerim që do ta marrim në konsideratë në janar, kur të bëjmë skemën për subvencionimin e sektorit të bujqësisë. Ne kemi vendosur të fokusohemi në subvencion direkt në sektorin e blegtorisë, si një sektor që ka ende potencial, por është i brishtë dhe kërkon të rritet.

Arben Ahmetaj – Zoti Ministër, ju falënderoj shumë për ekspozenë tuaj për sektorin dhe ju përgëzoj për punën e mirë që keni bërë në ministrinë tuaj, e reflektuar drejtpërdrejt në politika shumë më të kujdesshme ndaj fermerëve, e reflektuar me rritjen e eksporteve, e reflektuar me rritjen e gamës së produkteve, e reflektuar në rritjen e numrit të vendeve që presin eksportet tona, e reflektuar në raportin shumë interesant që treguat, ku vetëm 1% e eksporteve paraqitet me problematika, ndërsa 99% janë të konsoliduara, me cilësi shumë të mirë dhe me pritshmëri rritjeje vit pas viti, e reflektuar në raportin interesant që ju ndatë me ne, ku raporti ka qenë 1 me 8 në eksport-importin e vitin 2013, dhe ndër vite zbriti në 2,9. Kjo është domethënëse. Pra, po shkon sektor i dytë pas konfeksioneve dhe shumë shpejt do të ketë një bilanc tregtar pozitiv.

Unë jam i bindur se me politikat që po ndiqni dhe me punën e kujdesshme që po bëni në sektor, për 2 ose 3 vjet, nëse ecim me të njëjtën logjikë të eksportit, siç po ecim, mund të shkoj 1 me 1 dhe për 5 vjet kalon në pozitive, edhe me logjikën që theksuat me subvencionin tek investimet, te raporti shumë i drejtë: 1 dollar i investuar, 5 dollarë vlerë e shtuar, e cila është shumë e rëndësishme. Pra, bujqësia shumë shpejt do të jetë sektori i dytë pas konfeksioneve në aspektin e tregtisë së mallrave, sepse për tregtinë e shërbimeve kemi turizmin, i cili është me rritje spektakolare.

Zoti Ministër, kam një kërkesë, që stafi juaj të bëjë një skedë për komisionin me të gjitha arritjet, sepse është e domosdoshme! Ju lutem, promovoni të gjitha arritjet dhe problemet për t'i korrigjuar, në mënyrë që qytetarët, ne apo kushdo qoftë, edhe opozitarët e politikave që ne ndjekim, të shikojnë se si politikat reflektojnë suksese, apo kanë nevojë për korrigtim.

Zoti Ministër, faleminderit dhe punë të mbarë!

Mbledhja mbyllet.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti